

**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI KOMBETARE I UJIT  
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE**

**V E N D I M**

Nr. 4 Date 10. 12 .2012

**“PER  
MIRATIMIN E LEJES  
PER PERDORIM TE REZERVES UJORE  
PER PRODHIM HIDROENERGJIE.**

Bazuar ne ligjin nr. 8093 dt. 21.06.1996 “Per rezervat ujore”, neni 18 germa dh, dhe te vendimit nr. 87 dt. 16.01.2008 te K.M., “Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 27 dt. 19.01.2007 te K.M.”Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se koncesioneve”, te ndryshuar, ne Kreun XI, piken 9,”Shpallja e fituesit dhe negociimi i kontrates”,si dhe te V.K.M. nr. 708 dt. 21.05.2008, me propozim te A.U.B. Drin-Bune, Keshilli i Basenit Ujembledhes Drin-Bune :

**V E N D O S I :**

Miratimin e Lejes per Perdorim te Rezerves Ujore, ne lumin Gomsiqe, Puke, per “ Hidrocentralin Gomsiqe -1 “ shoqerise “HEC GOMSIQE” sh.p.k. per prodhim hidroenergjie, nga kuotat e vepres te marrjes ne lumin Gomsiqe + 273 m, perroin e Dushit +180 m, ne lumin Gomsiqe + 180 m, deri ne godinen e centralit ne kuoten + 77, ne lumin Gomsiqe.

Prurja qe do perdore shoqeria eshte  $Q = 7.405 \text{ m}^3/\text{sek}$ , ndersa prurje mesatare e lumit eshte  $Q = 7.405 \text{ m}^3/\text{sek}$ .

Shoqeria ka Kontrate Koncesionare me M.E.T.E. te formes “BOT” me Nr. 2851 Rep, Nr. 380 Kol. Dt. 10.09.2009, dhe miratim projekti te zbatimit te HEC-ve Gomsiqe 1 dhe Gomsiqe 2 me nr. 2795/4 prot dt. 27.09.2012, nga METE.

Leja e perdorimit te rezerves ujore per prodhim hidroenergjie jepet me kusht qe te mos kufizohet furnizimi me uje te pijshem dhe nevojave te bujqesise ne zone.

Ngarkohet A.U.B. Drin-Bune per zbatimin e ketij vendimi.

**PER KESHILLIN E BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE**

**Sekretari**

**Muhamet MUÇA**



**Kryetare**

**Voltana ADEMI**